



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 07.03.2018, miratoi këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA 2018-2020

Neni 1

Miratohet Vendimi i Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2018-2020.

Neni 2

Plani i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, i cekur ne nenin 1 të këtij vendimi, është bazuar në Strategjinë nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, të vitit 2013.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara 2018-2020.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-011/02-57596/18, më 09.03.2018



KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta